

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM / KANCELARIJA GENERALNOG REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL

Nr. dokumentit:21.11.1-2010-08

RAPORTI I AUDITIMIT

PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2010

Prishtinë, Qershor 2011

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme....4

I. Hyrje....5

II. Opinioni i auditimit....6

III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara....6

IV. Buxheti i shpenzuar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar....7

V. Pasqyrat vjetore financiare....8

V.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm....8
V.2 Cilësia e informatave....9

VI. Realizimi i Buxhetit....9

VI.1 Të Hyrat....9
VI.2 Shpenzimet....10
VI.3 Subvencionet dhe transferet....13
VI.4 Pasuritë dhe Borxhet....15

VII. Kontrolli mbi menaxhimin....16

VII.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm....16
VII.2 Auditimi i Brendshëm....18

VIII. Konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e MSH....19

Shtojca I. Komentet e MSH dhe përgjigja e ZAP....20

Shtojca II. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit....20

Lista e shkurtesave

AKPM	Agjencioni Kosovar për Produkte Mjekësore
AP	Auditori i Përgjithshëm
APP	Agjencioni i Prokurimit Publik
AQ	Administrata Qendrore
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
IMP	Instituti i Mjekësisë së Punës
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
LE	Lista Esenciale
LMFPP	Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji nr. 02/L-99 për Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar më 8 shkurt 2007, përfshirë ligjin e ri, nr. 03/L-241 në fuqi prej 1 dhjetor 2010
MAP	Ministria e Administratës Publike
MEF	Ministria për Ekonomi dhe Financa
MSH	Ministria e Shëndetsisë
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OE	Operatori Ekonomik
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit INTOSAI
PVF	Pasqyrat vjetore financiare
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës
SNA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
SR	Spitalet Regjionale.
TMJV	Trajtimi Mjekësor Jashtë Vendit
UA	Udhëzimi Administrativ

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Auditimi ynë është kryer në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të hartuara nga INTOSAI dhe ka përfshirë testet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Gjatë formulimit të opinionit ne vlerësuam mjaftueshmërinë e prezantimit të informacionit në pasqyrat financiare.

> Sipas opinionit tonë pasqyrat kryesore financiare *në të gjitha aspektet materiale* prezantojnë *pasqyrim të drejtë dhe të vërtetë*.
>
> (ISSAI 400: *Opinion i pakualifikuar*)

Auditimi ynë ka identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Këto dobësi janë të përshkruara më detajisht në brendi të raportit, të cilat duhet të adresohen nga menaxhmenti për të përmirësuar performancën e organizatës.

Rekomandimi ynë kryesor është që Ministri i MSH duhet të siguroj se janë zhvilluar udhëzime dhe procedura të qarta të cilat duhet të ndihmojnë adresimin e dobësive dhe mangësive të identifikuara në këtë raport. Ne rekomandojmë që veçanërisht të siguroni:

- Adresimin e të gjitha rekomandimeve nga vitet e kaluara;
- Të forcohen kontrollet në fushën e prokurimeve, sidomos në përzgjedhjen e operatorëve ekonomik dhe në monitorimin e projekteve;
- Kontrolle më efektive me rastin e pagesave për komisione dhe borde të caktuara;
- Monitorimin e subvencioneve në mënyrë të rregullt për të gjitha rastet që jepet subvencioni;
- Të forcohen kontrollet mbi menaxhimin e borxheve, dhe në rastet e buxhetit të mjaftueshëm, bartja e borxheve në vitin vijues të reduktohet në nivel minimal; dhe
- Forcimin e kontrolleve mbi monitorimin e furnizimit me barna, përkatësisht, menaxhim adekuat të barnave në depon qendrore.

Menaxhmentit të MSH i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti. Më pas, një numër ndryshimesh janë bërë në raport.

Menaxhmenti i MSH është zotuar se do t'i bëjë të gjitha përpjekjet që të adresoj rekomandimet e dhëna.

I. Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2010.

Është përgjegjësi e MSH të përgatisë pasqyrat vjetore financiare sipas kërkesave të Udhëzimit Administrativ (UA) 16/2010 dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për "Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme".

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë, duke përfshirë këtu edhe MSH.

Auditimi i rregullsisë përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Paraprakisht kemi kryer auditimin e përkohshëm të MSH. Gjatë asaj faze të procesit të auditimit, kemi adresuar faktin se si i keni trajtuar rekomandimet e mëparshme si dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Përmes Memorandumit të auditimit, kemi këshilluar menaxhmentin, ku janë përfshirë edhe këshillat dhënë për pasqyra vjetore financiare.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësive tona për auditimin e Ministrisë së Shëndetësisë, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar pasqyrat vjetore financiare të MSH në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2010;
- Kemi përcaktuar nëse pasqyrat vjetore financiare të MSH janë përgatitur në pajtim me SNKSP "Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme";
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të të hyrave dhe shpenzimeve, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare; dhe

- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare.

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi Pasqyrat Vjetore Financiare 2010.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të MSH-së, standardet ndërkombëtare të auditimit përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën 2.

II. Opinioni i auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat kryesore financiare *në të gjitha aspektet materiale* prezantojnë *pasqyrim të drejtë dhe të vërtetë*.

(ISSAI 400: *Opinion i pakualifikuar*)

III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara

Raporti ynë i auditimit të Pasqyrave Financiare për vitin 2009 kishte dhënë shtatë rekomandime. Katër prej tyre janë adresuar gjatë vitit 2010:

- Harmonizimet e rregullta raportuese për të hyrat mes MSH dhe Thesarit;
- Pranimi i barnave nga personat kompetent;
- Regjistrimi i pasurive; dhe
- Fokusi i auditimit të brendshëm në fusha me rrezik më të lartë.

Dy nga rekomandimet janë në fazën e implementimit:

- Rishikimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe marrja e masave ndaj personelit lidhur me fuksionet e deleguara; dhe
- Forcimimin e masave të kontrollit lidhur me zhvillimin e procedurave të prokurimit.

Ndërsa, nuk është adresuar fare rekomandimi që:

- të hyrat e inkasuara mbi vlerën 10€ për shërbimet shëndetësore të bëhen përmes llogarisë bankare nuk është adresuar.

Është e rëndësishme të theksohet se për mendimin tonë, mos adresimi i të gjitha rekomandimeve ka shkaktuar të njëjtat probleme sikurse ato të viteve të kaluara.

IV. Buxheti i shpenzuar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Shpenzimeve në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

Tabela 1: Përshkrimi i buxheteve dhe shpenzimeve **Në euro (€)**

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Rishikuar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar 2010	Buxheti i shpenzuar 2009
Grandi i Qeverisë – Buxheti	70,825,192	72,840,796	71,739,979	69,712,527	71,273,845
Të hyrat vetjake			3,799,325	3,677,656	3,098,001
Donacionet e vendit			58,082	58,076	
Donacionet e jashtme			1,971,601	1,356,079	1,503,283
I. Gjithsej të hyrat dhe transferi i donacioneve	**70,825,192**	**72,840,796**	**77,568,987**	**74,804,338**	**75,875,129**
Paga dhe mëditje	22,967,305	28,939,207	33,047,427	32,868,160	25,182,686
Mallra dhe shërbime	31,495,755	28,190,449	28,927,024	27,638,891	31,955,558
Shpenzimet komunale	3,417,073	3,514,073	3,373,319	3,342,579	3,352,104
Subvencionet dhe transferet	2,000,000	2,040,000	2,990,018	2,955,422	3,025,094
Investimet Kapitale	10,945,059	10,157,067	9,231,199	7,999,286	12,359,687
II. Gjithsej shpenzimet	**70,825,192**	**72,840,796**	**77,568,987**	**74,804,338**	**75,875,129**

Buxheti final nga Grandi i Qeverisë krahasuar me atë pas rishikimit ka pasur zvogëlim prej 1.51%. Kjo ka ndodhur sipas vendimit të Qeverisë dhe shkurtimit buxhetor për Radio Televizionin e Kosovës. Realizimi i shpenzimeve nga MSH për vitin 2010 ishte 74,804,338€, apo 96% e buxhetit të ndarë, duke përfshirë edhe donacionet.

MSH për vitin 2010 ka buxhetuar të hyra vetjake në vlerë 3,799,325€. Të hyrat e inkasuara ishin në shumë prej 3,692,338€.

Nga shuma totale e të hyrave të inkasuara, janë shpenzuar 3,667,656€. Shuma prej 773,430€ ishte bartur nga viti 2009.

Të hyrat nga grandet e përcaktuara të donatorëve (donacionet vendore dhe të jashtme) të cilat MSH i ka pasur në dispozicion gjatë vitit 2010 ishin 2,029,683€, nga të cilat janë shpenzuar 1,414,155€.

Konkluzioni

MSH e kishte shpenzuar buxhetin për vitin 2010 në kuadër të limiteve të përcaktuara nga Kuvendi. Vlera e buxhetit të shpenzuar për investime kapitale ishte afër 87% nga shuma e aprovuar.

Shërbimet operative-mjekësore në objektet e spitaleve shëndetësore gjatë kohës së renovimeve, kanë qenë faktorë i ngecjes së realizimit të kontratave për investimet kapitale.

MSH ka nivel të ulët të realizimit të donacioneve, rreth 69%. Kjo rrjedh nga fakti se politikat e realizimit të mjeteve përcaktohen nga donatorët. Këto projekte janë të planifikuara që të realizohen në kohë më të gjatë se një vit.

V. Pasqyrat vjetore financiare

V.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm

Bazuar në kërkesat e LMFPP nr. 03/L-048 dhe Udhëzimit Administrativ 16/2010, ne kemi identifikuar se PF përmbajnë pikat në vijim:

- Pasqyrat Financiare, janë në harmoni me kërkesat e UA 16/2010 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore;
- PF janë përgatitur në pajtim me SNKSP "Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme";
- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar i MSH-së;
- Pasqyrat Financiare janë dorëzuar në MEF/ Thesar, brenda kornizës kohore me datën 31.01.2011, të njëjtat janë dorëzuar vetëm në gjuhën shqipe; dhe
- Raportet financiare janë dorëzuar çdo tremujor tek MEF gjatë vitit 2010.

V.2 Cilësia e informatave

Përgatitja e pasqyrave financiare duhet të përmbledhë procedurat dhe mjetet e përcaktuara për të siguruar që informatat e prezantuara janë regjistruar, përpunuar, klasifikuar dhe raportuar drejt në pasqyra financiare në përputhje të plotë me kërkesat e raportimit si dhe me praktikat më të mira.

Pasqyrat Vjetore Financiare të MSH për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010 në përgjithësi ishin përgatitur sipas kërkesave të UA nr. 16/2010, përveç shënimeve të paraqitura më poshtë:

Tek neni 10 respektivisht raporti i ekzekutimit të buxhetit - pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për MSH, në pjesën e tabelës ku paraqiten daljet e parasë nga Llogaria e Vetme e Thesarit, MSH kishte paraqitur vetëm daljet e parasë nga llogaria e Grandit. Daljet nga të hyrat vetjake dhe donacionet nuk ishin përfshirë.

Konkluzioni

Ndonëse shpenzimet nga të hyrat vetjake dhe donacionet janë shpalosura në tabelat analitike të PVF, në përmbledhjen e përgjithshme ato nuk janë përfshirë. Për më tepër, tabela përmbledhëse e daljes së parasë nga llogaria e Thesarit duhet të përmbajë informatat komplete.

Rekomandimi 1

Rekomandojmë Ministrin e MSH të siguroj:

Korrigjimet e duhura në Pasqyra vjetore financiare, duke plotësuar raportin e ekzekutimit të buxhetit me të gjitha informatat e nevojshme.

VI. Realizimi i Buxhetit

VI.1 Të Hyrat

MSH realizon të hyra nga: participimet, licencat të ndryshme për produkte mjekësore, qiraja e objekteve publike, të hyra nga parkingu, të hyra nga licencat individuale dhe të lira, banderolat, çertifikatat mjekësore, gjobat nga inspektoratet si dhe nga taksat tjera. MSH bën alokimin e të hyrave vetjake sipas memorandumit mes MEF dhe MSH.

MSH, për vitin 2010 kishte planifikuar një buxhet nga të hyrat në shumën 3,799,325€, derisa shuma e inkasuar ishte 3,692,338€, duke përfshirë edhe të hyrat e bartura nga viti i kaluar

prej 773,430€. Shpenzimi i të hyrave vetjake ishte 3,667,656€, apo 99% nga vlera e inkasuar. Kryesisht të hyrat vetjake janë shpenzuar për paga dhe mëditje.

Gjendja e raporteve të të hyrave mes MSH dhe Thesarit ishte e harmonizuar. Megjithëkëtë janë vërejtur dobësi në mbajtjen e evidencave nga njësi të caktuara të MSH.

Mungesa e evidencave për të hyra në Njësitë e MSH

Ne kemi vërejtur se për të hyrat nga participimi në QKUK, nuk janë mbajtur evidenca adekuate nga zyret e kontabilitetit dhe financave.. Dëftesëpagesat nga arkat ndihmëse nuk i janë dorëzuar arkëtarit kryesor së bashku me raportin ditor, siç kërkohet me UA 04/2007. Kjo bën të pa mundur një vlerësim të përgjithshëm mbi madhësinë e të hyrave në QKUK.

Po ashtu, edhe në AKPM, zyra e financave nuk ka një regjistër të plotë, për sa i takon të hyrave të mbledhura nga ky institucion.

Konkluzioni

Mos mbajtja e duhur e shënimeve për të hyra në regjistra të njësive vartëse të MSH, krijon mundësinë që këto të hyra të mos raportohen drejtë. Po ashtu, është e rëndësishme që të hyrat e mbledhura të deponohen pa vonesë në llogari të MSH në pajtim me rregullat e përcaktuara.

Rekomandimi 2

Rekomandojmë Ministrin e MSH të siguroj:

- Forcimin e kontrolleve të brendshme si dhe monitorimin e njësive vartëse të MSH, në mënyrë që evidencat kontabël për të hyrat, të mbahen në pajtim me UA 04/2007. (Mbledhja dhe shfrytëzimi i mjeteve nga bashkëpagesat e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore dhe të hyrat vetjake të institucioneve shëndetësore)

VI.2 Shpenzimet

2.1 Blerjet përmes prokurimit

Shpenzimet për projekte kapitale dhe ato për mallra e shërbime, të cilat kanë kaluar përmes procedurave të prokurimit ishin në vlerë prej 33,976,298. Nga kjo vlerë, ne kemi testuar 104 mostra në vlerë prej 10,812,911 apo 31%.

Ndarje e tenderëve për furnizim me pajisje mjekësore nga QKUK

Në lidhje me dy kontrata që kishte lidhur QKUK dhe OE dhe atë për "Furnizim me pjesë rezervë për aparatura të klinikave" dhe "Furnizim me Vapora" kemi vërejtur se dy nga tre operatorët ekonomik nuk i plotësojnë kushtet e tenderit.

QKUK në dosjen e tenderit kishte kërkuar nga operatorët ekonomik një vërtetim mbi kryerjen e obligimeve ndaj Administratës Tatimore të Kosovës, valid së paku deri në tremujorin e fundit. Operatorët fitues kishin dorëzuar vërtetim mbi gjendjen e pagesës së tatimit më të vjetër se gjashtë muaj.

Gjatë testimit të këtyre dy lëndëve, ne kemi vërejtur se të dy tenderët kanë të bëjnë me të njëjtin furnizim. Ndarja e tenderit në dy pjesë është në kundërshtim me LPP.

Faturimi për shërbimet e kryera, para se kontrata të nënshkruhet

Tek lënda "Servisimi i automjeteve" me vlerë prej 9,994€, kemi vërejtur se kontrata është nënshkruar me datë 07/12/2010, derisa operatori ka faturuar MSH-në para kësaj date. Vlera e tri faturave të cilat i janë adresuar MSH-së për pagesë është 3,875€.

Mungesa e planit të prokurimit në AKPM

AKPM gjatë vitit 2010 të gjitha prokurimet i ka zhvilluar pa e pasur planin të aprovuar nga APP, gjë që është në kundërshtim me pikën 1 dhe 2 të nenit 7 të LPP-së. Përveç kësaj, dosjet e lëndëve në departamentin e prokurimit nuk janë të kompletuara.

Nënshkrimi i kontratës pa zotim të mjeteve

Në dy kontrata të cilat i ka nënshkruar QKUK për furnizim me pajisje mjekësore, kemi vërejtur se nuk ka pasur zotim të mjeteve. Kontratat janë nënshkruar në fund të vitit 2010, ndërsa zotimi i mjeteve është bërë në vitin 2011. Për më tepër, zotimet nuk e mbulojnë shumën e kontraktuar.

Pranimi i barnave me afat skadence më të shkurtër sesa një vit

Gjatë testimit të pagesave për furnizim me barna, kemi hasur se në faturat të cilat i kishte pranuar MSH, ishin të përfshira barnat me afat skadence më të shkurtër se një vit. Me kontratë parashihet që barnat të cilat i ofrohen MSH nga operatorët e kontraktuar, të kenë afat skadence minimum së paku një vit.

Konkluzioni

Dobësitë dhe mangësitë e theksuara më lartë janë tregues se procedurat e prokurimit në MSH kanë nevojë për përmirësim dhe se kontrollet duhet të zhvillohen edhe më tepër. . Dhënia e kontratave OE që nuk plotësojnë kushtet e tenderit, faturimet para se kontrata të nënshkruhen, mungesa e planeve të prokurimit dhe hyrja në kontrata pa fonde të nevojshme rrisin rrezikun që MSH të mos menaxhoj si duhet me fondet publike.

Monitorimi apo mbikëqyrja e dobët e furnizimit me barna të kontraktuar, është një çështje e veçantë për shqetësim.

Rekomandimi 3

Rekomandojmë Ministrin e MSH të siguroj:

- Të merren në konsideratë vetëm ofertat serioze, ashtu siç janë të parapara me kornizën ligjore, dhe të mos zhvillohen procedura në mungesë të operatorëve të përgjegjshëm, si dhe mos të ketë praktika të ndarjes së tenderëve;
- Të ndërprehet praktika e pranimit dhe pagesës së faturave, para se kontrata të nënshkruhen;
- Që brenda afateve të parapara ligjore, të përgatiten planet preliminare dhe finale të prokurimit dhe të njëjtat t'i dorëzohen APP-së; dhe
- Që para se të fillohet me aktivitetet e prokurimit, fondet e nevojshme të jenë zotuar.

2.2 Blerjet tjera

Pagesa nga kodet joadekuate

Në kuadër të MSH veprojnë rreth 12 komisione, borde dhe grupe punuese.Ato janë të emëruara me vendim të Ministrit të MSH-së.

Për pagesën e kompensimeve për anëtarë të bordeve, komisioneve dhe grupeve të ndryshme profesionale, MSH ishin buxhetuar mjete nga kodi 903 (Mjekët në vend). Vlera e buxhetuar për kompensimin e shërbimeve të kryera nga anëtarët e komisioneve, bordeve dhe grupeve punuese është rreth 116,210€.

Në dy raste kemi vërejtur se shpenzimet të cilat janë paguar nuk korrespondojnë me natyrën e programit nga i cili është bërë pagesa e këtyre shpenzimeve.

Nga kodi i programit 903 (Mjekët në Vend), vlera prej 5,500€, është paguar për dy përfitues për trajtim jashtë vendit, derisa kodi i programit 716 (TMJV) është programi adekuat nga i cili kryhen këto pagesa.

Konkluzioni

Sipas Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike, zyrtarët (shërbyesit civil) të cilët marrin pjesë në komisione, borde ose ndonjë organ apo autoritet tjetër publik, nuk kanë të drejtë të pranojnë kurrfarë kompensimi shtesë për këtë shërbim. Shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme të postit të cilin e mban punonjësi, shërbyesi civil ose zyrtari i sipërcekur.

Pagesa e shpenzimeve në kodet ekonomike jo përkatëse ka ndikim negativ në regjistrimin e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike adekuate.

Rekomandimi 4

Rekomandojmë Ministrin e MSH të siguroj:

- Rishikimin e pagesës ndaj këtyre anëtarëve të komisioneve dhe bordeve, në pajtim me rregullat aktuale; dhe
- Regjistrim të shpenzimeve në kode adekuate sipas natyrës dhe qëllimit të përcaktuar.

2.3 Kompenzimet (pagat dhe mëditjet)

Për vitin 2010 buxheti i MSH për kompensime, duke përfshirë edhe donacionet ishte 33,047,427€. Sipas të dhënave të Free Balance-it, buxheti ishte shpenzuar 32,868,160€ apo mbi 99% .

Ne kemi testuar 43 mostra lidhur me pagesën dhe rregullsinë e dosjeve të personelit. Për më tepër kemi testuar shpenzimet mujore për paga dhe mëditje duke bërë krahasimin listën e punëtorëve në sistemin e Payrollit.

Duke pas parasysh se sistemin e administrimit dhe procesimit të pagave e bën MSH, ndërkaq ekzekutimin e tyre Ministria e Administratës Publike, konkludojmë se sistemi i pagave dhe kontrolli i shpenzimeve të pagave ka funksionuar mirë. Informatat financiare janë prezantuar drejtë dhe kjo është parakusht që edhe Pasqyrat Vjetore Financiare të jenë të besueshme dhe të sakta. Po ashtu, përmirësim është vërejtur edhe në mirëmbajtjen dhe azhurnimin e dosjeve të personelit.

VI.3 Subvencionet dhe transferet

Shuma e buxhetuar për kategorinë Subvencione dhe transfere, duke përfshirë edhe donacionet, është 2,990,018€, ndërsa shpenzimi i tyre është 2,955,421 apo 99%. Vetëm nga Buxheti i Kosovës pa donacione janë shpenzuar 2,288,443€, prej të cilave 2,249,947€ janë shpenzuar nga Programi për Trajtim Mjekësor Jashtë Vendit dhe 38,496€ nga Programi Mjekët në Vend.

Mungesa e dëshmive për shpenzimet e ndodhura në programin TMJV

Nga mostrat e testuara kemi vërejtur se nuk ekzistojnë dëshmitë, e as faturat se pagesat janë bërë në vendin e duhur dhe për mjekimin e duhur. Ne kemi gjetur se ekzistojnë vetëm profaturat ose vlerësimi i spitalit se sa mund të kushtojë mjekimi në fjalë. Pagesa nga ky program ishin bërë në shumën 2,249,947€. Të gjitha pagesat janë bërë në formë avanci.

Emrat e anëtarëve të komisionit mungojnë në dokumentin e aprovuar

Me qëllim që të vlerësohen kërkesat e dorëzuara nga aplikuesit për trajtim jashtë vendit, MSH ka të themeluar komisionin dhe bordin për TMJV.

Në testimet tona ne kemi vërejtur se në një rast emrat e anëtarëve të komisionit nuk figurojnë në dokumentin e aprovuar. Gjashtë raste të cilat janë proceduar dhe aprovuar në vitet paraprake janë paguar në vitin 2010. Vlera e këtyre pagesave është 52,500€.

Mosrespektim i kritereve për trajtim jashtë vendit

Ne kemi bërë verifikimin e pagesave lidhur me skemën e trajtimit jashtë vendit. Kemi vërejtur se një aplikant nuk i kishte përmbushur kriterin mbi ofrimin e dëshmisë në aspektin e mundësisë financiare.

UA nr.7/2003 për Implementimin e Programit për Trajtim Mjekësor Jashtë Vendit, parasheh që të verifikohet edhe aspekti i mundësisë financiare të pacientit për trajtim jashtë vendit.

Mungesa e monitorimit të subvencioneve

Në katër raste nuk kishte raport me shkrim të punës së kryer. Gjithashtu nuk kishte raport financiar i cili parashihet me Memorandumin e Mirëkuptimit në mes të MSH dhe Organizatat jo Qeveritare, të cilat kanë përfituar mbështetje financiare. Në dy raste memorandumi i mirëkuptimit është nënshkruar pasi ka ndodhur shpenzimi. Shuma e totale e këtyre pagave ishte 10,600€.

Konkluzioni

Konkluzioni ynë është që MSH nuk ka arritur që të bëj trajtimin e duhur të aplikacioneve, duke devijuar nga kriteret në UA 7/2003. Po ashtu, monitorimi jo i mjaftueshëm i shpenzimeve, tregon dobësi të kontrollit të brendshëm në ndjekjen e procedurave për dhënien e subvencioneve. Të gjitha këto, rrisin rrezikun që subvencionet të jenë shpenzuar në mënyrë jo racionale.

Rekomandimi 5

Rekomandojmë Ministrin e MSH të siguroj:

- Respektimin e përpiktë të UA 7/2003 dhe UA nr. 03/2010 "Programi për trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike", në të cilin qartë definohen kriteret për përfituesit e këtij programi; dhe
- Forcimin e kontrolleve për monitorimin e projekteve të cilat subvencionohen nga MSH, për të siguruar se fondet shfrytëzohen sipas dedikimit.

VI.4 Pasuritë dhe Borxhet

4.1 Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj

Gjendja e parasë së gatshme më 31/12/2010 në llogarinë e MSH në Bankë tregon një saldo kreditore prej 15,117€. Kjo shumë ka të bëjë me kthimin e mjeteve nga llogaria e avanceve, të cilat zyrtarët e MSH i kanë kthyer pas udhëtimeve zyrtare. Shuma totale e avanceve të hapura në MSH ishte rreth 640,621€.

Avanci i hapur në vlerë prej 635,756€ ka të bëjë me furnizimin e vaksinave. Ky avancë është dhënë me aprovimin e Kuvendit të Kosovës dhe përfitues i tij është UNICEF (UNICEF e ka të drejtën ekskluzive për shpërndarjen e këtij lloji të vaksinës). Ky avanc mbetet të mbyllet pas furnizimit me gjitha barnat sipas marrveshjes.

Avancet e pambyllura nga udhëtimet zyrtare në fund të vitit 2010 ishin në vlerën prej 4,865€.

4.2 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale

MSH në fund të vitit 2010 kishte bërë inventarizimin e pasurisë. Zyrtari i pasurisë në MSH kishte regjistra për pasurinë e MSH. Po ashtu, edhe në njësitë tjera të MSH është bërë inventarizimi i pasurive. Pasuritë ishin të shënjuara dhe të identifikuara. Për më tepër, vlera e pasurive të regjistruara në Free Balance është shpalosur drejtë në PVF.

4.3 Borxhet

Pasqyra e obligimeve të pa paguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2010 ishte 2,952,420€. Këto obligime barten për pagesë në vitin fiskal 2011. Në vijim po i paraqesim obligimet sipas programeve të MSH:

QKUK 1,471,936€, SR Gjilan 387,435€, SR Prizren 320,892€, SR Gjakovë 104,131€, SR Pejë 198,227€, SR Mitrovicës 9,384€, SR Vushtrri 1,620€, SR Ferizaj 55,039€, IKSHPK 14,095€, Shërbimi Profesional i Shëndetit Mendor 62,827€, IMP Gjakovë 33,965€, Qendra e Telemedicinës 21,497€, AQ 21,827€, dhe Programi Farmaceutik 241,021€.

Pjesa më e madhe e obligimeve kanë mbetur të pa paguara për arsye të mungesës së buxhetit (Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Spitalet Regjionale si dhe Institutet në kuadër të MSH). Pjesa tjetër nuk ishin paguar për arsye të arritjes me vonesë të faturave. kur është fjala për Programin Farmaceutik, kontratat nuk janë implementuar në tërësi.

Pagesa për shërbime për dy qendrat rehabilituese

Pagesat për dy qendrat e rehabilitimit: në Pejë dhe Kllokot, janë bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit me Bashkimin e Pensionistëve Invalidor dhe të Punës të Kosovës.

Shuma totale e pagesave për këto dy qendra ishte rreth 19,581€. Këto obligime të cilat janë bartur në vitin 2010, nuk ishin të prezantuara si obligime të papaguara në PVF të vitit paraprak.

Konkluzioni

MSH nuk ka kontrolle të mjaftueshme mbi menaxhimin e borxheve. Fakti se gati 3 milionë janë bartur për pagesë në vitin 2011, është një sinjal se planifikimi i MSH ka hapësirë për përmirësim. Por as raportimi nga njësitë vartëse nuk është duke funksionuar siç duhet.

Kjo rrit rrezikun që të krijohen vonesa në pagesën e obligimeve, të bëhen konteste ligjore nga ana e furnitorëve dhe të paguhen ndëshkimet për vonesa. Pagesat në vitin 2010 për obligimet e pa prezantuara në PF të vitit 2009, po ashtu rrit dyshimet se edhe këtë vit, obligimet e pa paguara nuk janë shpalosur në tërësi.

Rekomandimi 6

Rekomandojmë Ministrin e MSH të siguroj:

- Forcimin e procedurave administrative dhe kontrolleve të obligimeve të pa paguara nga të gjitha njësitë raportuese të MSH (spitalet regjionale, QKUK dhe shërbimeve tjera shëndetësore), duke harmonizuar buxhetet aktuale me aktivitetet operuese; dhe
- Se të gjitha faturat, situacionet dhe dokumentet tjera për pagesë të procesohen para datës së mbylljes së sistemit të pagesave dhe bartja e obligimeve në vitin vijues të reduktohet në nivelin minimal.

VII. Kontrolli mbi menaxhimin

VII.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

Udhëzimet, procedurat, politikat dhe masat e tanishme të kontrollit të brendshëm, konkludojmë se vetëm pjesërisht përmbushin objektivat e synuara të menaxhmentit. Por këto sisteme dhe masa nuk ofrojnë siguri të mjaftueshme se niveli i rrezikut për gabime është reduktuar në nivelin minimal.

Përveç kapitullit të pagave dhe mëditjeve, ku kontrollet vlerësohet të kenë funksionuar mirë, në fushat tjera janë vërejtur dobësi të menaxhimit efektiv. Për më tepër, MSH nuk ka arritur të ndërmerr hapa të mjaftueshëm për ta përmirësuar situatën në prokurim, si një fushë e e cenuar nga rreziqet. Regjistrimi, dëshmitë e mangëta, barazimi i bilanceve midis departamenteve përkatëse me atë të financave dhe deponimi i të hyrave vazhdon të jetë një çështje brengosëse.

MSH ka depon qendrore në të cilën menaxhon furnizimin e barnave esenciale (Listën Esenciale). Regjistrimi i barnave në depo bëhet përmes softuerit të cilin e ka kontraktuar MSH në dhjetor të vitit 2010. Mirëpo, ekzaminimi i disa kartelave të barnave të regjistruara në sistem paraqet saldo negative, që tregon se nuk ka përputhje mes hyrjes dhe daljes së barnave në sistem. Kjo gjendje krijon dyshimin se menaxhimi i stokut të barnave dhe regjistrimi i tyre në sistem nuk përcillet si duhet.

Përveç kësaj gjendja e barnave me afat të skaduar në depo është në vlerë prej 519,158€. Kjo vler blera nga vitet 2008, 2009 e 2010.

Konkluzioni

Shembujt e përshkruar në këtë raport, sinjalizojnë se nevojitet një qasje e re në dizajn si dhe në implementimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm. Rreziqet për mos shfrytëzimin e parasë publike në mënyrë ekonomike, efektive, efikase duhet të minimizohen.

Rekomandimi 7

Rekomandojmë Ministrin e MSH të siguroj:

- Se Sekretari Permanent ndërmerr masat për ta rishikuar dizajnin dhe implementimin e kontrolleve të brendshme. Kur kjo të bëhet duhet të analizohet se a janë udhëzimet dhe procedurat të qarta dhe të plota. Më pastaj, të rivlerësohet nëse ekziston një ndarje e qartë e detyrave me përshkrimet e nevojshme si dhe të vlerësohen shkathtësitë profesionale të stafit në arritjen e objektivave të MSH; dhe

- Forcimin e kontrolleve mbi monitorimin e furnizimit me barna për të siguruar një menaxhim më adekuat të barnave në depon qendrore dhe duke ulur sasinë e stoqeve me afat të skaduar në minimum.

VII.2 Auditimi i Brendshëm

MSH ka themeluar NJAB dhe si e tillë funksionon në pajtim me kërkesat ligjore. Ajo ka planin strategjik dhe planin vjetor të punës, i cili është i aprovuar nga Komiteti i Auditimit. NJAB përbëhet nga drejtori dhe tre zyrtarë të auditimit të brendshëm. Stafi i NJAB ka përgatitje të duhur profesionale dhe ka ndjekur trajnimet e nevojshme rreth auditimit të brendshëm.

NJAB ka pregaditur 13 raporte finale të auditimit për vitin 2010, njëmbëdhjetë prej të cilave kanë objektivë auditimin për vitin 2010. NJAB ka përmbushur planin e saj vjetor për sa i takon raporteve të finalizuar. NJAB e MSH ka bërë edhe auditime me kërkesë specifike.

Edhe QKUK ka NJAB, e cila ka planin strategjik dhe planin vjetor të aprovuar nga Komiteti i Auditimit. NJAB në QKUK për vitin 2010 ka finalizuar rreth 5 raporte, dy sipas planit ndërsa tri të tjera me kërkesë specifike. NJAB e QKUK ballafaqohet me mungesë të stafit e cila është reflektuar në mospërmbushjen e planit vjetor.

Raportet e NJAB-së, janë mjaft përmbajtjesor, dhe kanë trajtuar çështje që janë me rrezik relativisht të lartë, sikurse procedurat e prokurimit, deponimi dhe shpërndarja e barnave, investimet kapitale dhe fusha të tjera të auditimit. MSH e ka të formuar komitetin e auditimit, i cili kishte mbajtur 4 takime në vit. Komiteti i Auditimit ka qenë aktiv dhe ka marrë për bazë gjitha çështjet të cilat janë potencuar nga NJAB tek menaxhmenti i MSH-së. Pavarësisht nga raportet e lartcekura, rekomandimet e NJAB nuk janë në proces të implementimit.

Konkluzioni

Konkludimi ynë është se Auditimi i Brendshëm në MSH është duke funksionuar në nivel të kënaqshëm. Menaxhmenti i MSH duhet të merr në konsideratë të gjitha këshillat dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të fuqizoj edhe më shumë rolin e tij.

Rekomandimi 8

Rekomandojmë Ministrin e MSH të siguroj:

- Vazhdimin e forcimit të rolit të auditimit të brendshëm, duke i zbatuar me kujdes të gjitha këshillat dhe rekomandimet e dala nga raportet.

VIII. Konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e MSH

Konkluzionet e përgjithshme

Konkludimi jonë është se menaxhmenti duhet ta ri adresojë menaxhimin financiar dhe kontrollin brenda Ministrisë. Disa nga gabimet dhe parregullsitë e identifikuara gjatë këtij viti janë përsëritur nga viti i kaluar. Proceset e prokurimit përcillen me dobësi të shumta dhe ngrisin dyshimin nëse ofrojnë vlerën e duhur për paratë.

Hyrja e MSH në obligime pa siguruar fondet buxhetore rrezikon të sjellë MSH në situata të vështira financiare dhe lë të hapur mundësinë e kontesteve të shumta gjyqësore.

Nuk është i qartë fakti se në fund të vitit mbi 500,000€ janë gjetur barna me afat të skaduar. Prandaj, masa shtesë të kontrolleve gjithashtu nevojiten tek furnizimet me barna dhe një kujdes i veçant duhet kushtuar deponimit, ruajtjes dhe shpërndarjes së tyre.

Është dekurajues fakti se menaxhmenti i MSH, përkundër rekomandimeve të dhëna vitin e kaluar dhe viteve paraprake, nuk ka shënuar ndonjë progres domethënës gjatë vitit 2010.

Rekomandim i përgjithshëm

Rekomandojmë Ministrin e MSH të siguroj:

- Se Sekretari Permanent inicion një analizë të gjithanshme e të gjitha dobësive dhe mangësive dhe hartimin e një pako masash nën administrimin e tij direkt për përmirësimin dhe eliminimin e tyre; dhe
- Të hartoj një plan veprimi, duke përcaktuar masat e menjëhershme, afatet e qarta kohore dhe bartësit e përgjegjësive për zbatimin e tij.

Shtojca I. Komentet e MSH dhe përgjigja e ZAP

Menaxhmentit të MSH i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti. Më pas, një numër ndryshimesh janë bërë në raport.

Menaxhmenti i MSH është zotuar se do t'i bëj të gjitha përpjekjet që të adresoj rekomandimet e dhëna.

Shtojca II. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një opinion i pakualifikuar jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

(a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuara të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistonte (të qëndrueshme);

(b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;

(c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;

(d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. Theksi i çështjeve. Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifikë të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinioni. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor

nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund **të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar** kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

(a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;

(b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustifikuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo

(c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. Opinioni i Kualifikuar. Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar.

I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. Opinioni i Kundërt. Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinioni që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinioni të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. Mohimi i Opinionit. Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restrikcionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinioni të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.